

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË GJILAN, sipas gjyqtares Mirvete Alidemi dhe sekretares juridike Hamide Zymberi, duke vendosur në lëndën për kundërvajtje ndaj të pandehurit Bahtijar Kryeziu nga Gjilani, për shkak të veprës kundërvajtës – mosdeklarim i rregullt vjetor i pasurisë të parashikuar nga neni 6 paragrafi 2 dhe i ndëshkuar sipas nenit 16 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit për Deklarimin , Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarve të Lartë Publik Nr. 03/L-151 të dt. 11 shkurt 2010, e sipas kërkesës për kundërvajtje të Agjencisë Kundër Korrupsionit nga Prishtina NR. 01-2313/10 të dt. 08.06.2010, pas mbajtjes së séanceës gjyqësor, e në bazë të nenit 73, 74, 195 dhe nenit 198 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, më dt. 20 janar 2012, mori këtë:

A K T V E N D I M

PEZULLOHET procedura kundërvajtëse ndaj të pandehurit Bahtijar Kryeziu, i lindur më 1 gusht 1949, me vendbanim në Gjilan, lagja “ Dardania “ II rruga nr.9/21, Profesor në Fakultetin e Edukimit në Gjilan, për shkak të veprës kundërvajtëse – mosdeklarim i rregullt vjetor i pasurisë të parashikuar nga neni 6 paragrafi 2 dhe i ndëshkuar sipas nenit 16 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit për Deklarimin , Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarve të Lartë Publik , në pajtim me nenin 198 paragrafi 1 pika 2 të Ligjit mbi Kundërvajtjet për shkak të ekzistimit të rrethanave që e përjashtojnë përgjegjësinë kundërvajtëse.

Me nga nje kopje të këtij aktvendimi të njoftohen palët në procedurë.

A r s y e t i m

Agjencia Kundër Korrupsionit nga Prishtina i ka paraqitur kësaj gjykate kërkesë nr. 01-2313/10 të dt. 08.06.2010 për fillimin e procedurës për kundërvajtje ndaj të pandehurit Bahtijar Kryeziu nga Gjilani , për shkak të veprës kundërvajtëse- mosdeklarim i rregullt vjetor i pasurisë të parashikuar nga neni 6 paragrafi 2 dhe i ndëshkuar sipas nenit 16 paragrafi 1 pika 11 të Ligjit për Deklarimin , Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarve të Lartë Publik Nr. 03/L-151 të dt. 11 shkurt 2010, dhe ka kërkuar që i njëjti të shpallet përgjegjës dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjyqtarja, shqyrtoi kërkesën e parshtruar dhe konstatoi që e njëjtat është e ligjshme si dhe zhvilloi procedurën kundërvajtëse me dëgjimin e të pandehurit Bahtijar, i cili në mbrojtjen e dhënë në këtë gjykatë nuk e pranoi kundërvajtjen e cila i vebet në barrë duke u arsyetuar se nga data 5 mars 2010 e deri më datën 25 maj 2010, e ka ushtruar detyrën e Prodekanit në Fakultetin e Edukimit në Gjilan , për arsye të një aksidenti që kishte pësuar Prodekani i emëruar në këtë detyrë dhe se gjatë kohës që e ka ushtruar detyrën nuk ka qenë i njoftuar nga askush që gjendet në listen e zyrtarve të lartë publik , të cilët janë të obliguar ta deklarojnë pasurinë si dhe që nuk i është ofruar formulari për plotsimin e pasurisë, në bazë të së cilës do ta permbushte obligimin ligjor, Për këto arsye ka kërkuar nga gjykata të lirohet nga përgjegjësia.


Nga të dhënat e parashtruara në kërkesë , nga deklarata atë pandehurit si dhe vlersimin e provave të deponuara në shkresat e lëndë, gjyqtarja konstatoi që ekzistojnë rrethanat që e përjashtojnë përgjegjësinë kundërvajtëse andaj, në mbështetje të nenit 198 paragrafi 1 pika 2 të Ligjit mbi Kundërvajtjet ndaj të njëjtit e PEZULLIO procedurën kundërvajtëse.

Nga të cekurat e mësipërme u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

VENDOSUR NË GJYKATËN PËR KUNDËRVAJTJE NË GJILAN

Më dt. 20 janar 2012

Sekretarja Juridike ,
Hamide Zeqiri



Gjyqtarja
Mirvete Alidemi

DPK / DMP

03-496/2012

01

03.02.2012

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, në Gjykatën e Lartë Për Kundërvajtje në Prishtinë. Ankesa dorzohet përmes kësaj Gjykate.